



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA HIMARË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

**Lënda :** Kthim përgjigjeje kërkesës suaj me datë 02.11.2021.

**‘ALBANIA QUALITY JOURNALISM’**

**TIRANË**

Në vijim të kërkesës suaj të datës 02.11.2021 dërguar në institucionin tonë me postë elektronike, regjistruar tek ne me nr.4708.prot, me datë 09.11.2021, me të cilën kërkonti informacion mbi punonjësit e shërbimit social në Bashkinë Himarë, ju bëmë me dije se :

Në përgjigje të kërkesës së pare mbi shkollimin që kanë punonjësit apo zyrtarët e shërbimit social ju njoftojmë se në strukturën e Bashkisë Himarë janë tre punonjëse në sektorin e ndihmës dhe shërbimit social, ku vetëm dy prej tyre kanë arsim të lartë dhe një me arsim të mesëm..

Lidhur me kërkesën e eksperiencave të mëparëshme para se të punësoheshin si zyrtarë për shërbimin social ju bëjmë me dije se nuk kanë eksperiencë të mëparëshme.

Për sa i përket kërkesës për trajnimet e këtyre punonjësve 5 vitet e fundit ju komunikojmë se punonjësit kanë marrë pjesë në trajnime mbi sisteme të ndryshme si ai i ndihmës ekonomike, sistemi i PAK-së, sistemi për pakicat romë dhe egjyptiane, sistemi mbi qeverisjen digitale dhe trajnime mbi ngritjen e kapaciteteve në bashki për ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETARI I BASHKISË**

**Jorgo Goro**